

THIRRJE PER SHPREHJE INTERESI

Panoramë e Përgjithshme

Partnerët Shqipëri prej një viti po zbaton një prej nismave më inovatore në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të OJFve (që veprojnë në fushën e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe qeverisjes së mirë, respektimit të të drejtave të njeriut etj), për të identifikuar modele të reja biznesi në funksion të gjenerimit të të ardhurave duke siguruar qëndrueshmëri financiare e pavarësi nga burimet e zakonshme të financimit, për një impakt më të madh në komunitetet ku veprojnë.

Përveç një serie programesh trajnimi, konsulence dhe mentorimi afatgjatë mbi adoptimin e modeleve të përshtatshme të biznesit për të rritur e diversifikuar të ardhurat, Partnerët Shqipëri do t'i kushtojë një rëndësi të veçantë ngritjes së urave të bashkëpunimit me sektorin privat për njohjen e punës së organizatave të shoqërisë civile dhe shërbimeve të tyre, si dhe identifikimin e mundësive konkrete të partneritetit për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në këtë kuadër, PSH do të organizojë gjatë muajit **shtator 2017** eventin

“OJF - Biznes speed-dating”

dhe fton të gjithë OJF-të e interesuara të aplikojnë për pjesëmarrje.

Çfarë është “OJF-Biznes speed-dating”?

“OJF - Biznes speed-dating” do të jetë një event një-ditor takimesh gjysëm të strukturuar, midis përfaqësuesve të sektorit jo fitimprurës dhe atij privat me qëllim krijimin e kontakteve përmes ekspozimit direkt; prezantimit dhe promovimit të shërbimeve dhe produkteve dhe gjetjen e formave të mundshme të bashkëpunimit për të ardhmen.

Si do të realizohet?

Aplikimi për pjesëmarrje

Plotësoni formën e aplikimit - prezantoni profilin e organizatës suaj; çfarë lloj shërbimi/produkti, ekspertize dhe teknologjie që jeni të interesuar të promovoni. Shprehni interesin mbi llojin e biznesit që doni të takoni dhe cilat janë pritshmëritë tuaja nga ky takim.

Informimi mbi aktivitetin

Partnerët Shqipëri do t'ju informojë rreth dy javë para datës së organizimit të aktivitetit mbi detajet e tij (koha, vendi, etj) dhe planin e takimeve i cili do të ndërtohet bazuar në shprehjen e interesit nga të dyja palët.

Përgatitja dhe pjesëmarrja në takim

Jini të përgatitur për prezantimet tuaja gjatë takimeve me bizneset pjesëmarrëse të cilat do të zgjasin 5-10 minuta. Kartvizitat personale dhe materialet promociionale janë mjetet e duhura për prezantimin tuaj, të organizatës, shërbimeve /produkteve që jeni të interesuar të promovoni.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve

Nxiti të aplikoni - vendet janë të limituara!

Partnerët Shqipëri do të përzgjedhë vetëm **15 organizata** për të marrë pjesë në këtë aktivitet!

Përzgjedhja do të bazohet në parimin – kush aplikon i pari, përzgjidhet!

Lutemi të dërgoni [Formën e aplikimit](#) jo më vonë se data **6 shtator 2017** tek partners@partnersalbania.org

ose dorazi apo me postë në adresën:

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
Rr. Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12,
Njësia Bashkiake 5, Kutia Postare
(PO Box) 2418/1

*Ky aktivitet mbështetet nga
Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës
së Shteteve të Bashkuara në Tiranë.*